

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mirëmbajtja e sistemeve të sigurisë për 3 vite

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8
- Paketa software për industri specifike. 48000000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

42.505.766.4 (Dyzet e dy milion e pesëqind e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë katër)leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës10;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (tre vitet e fundit) 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit për këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter është vendosur në mënyrë që të garantohet një nivel i pranueshëm në lidhje me eksperiencën, besueshmërinë, përvojën në kontrollin e llogarive të entiteteve të krahasueshme.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të shërbimeve të mëparshme të mirëmbajtje të sistemeve të sigurisë, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak 40 % nga vlera e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë.

- a) ISO 9001:2015: Për menaxhimin e cilësisë, që ka lidhje me objektin e kontratës – *Mirembajtje Sisteme Sigurie*;
- b) ISO 20000-1:2018: Për menaxhimin e sistemeve të informacionit, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit – *Mirembajtje Sisteme Sigurie*;
- c) ISO 27001:2022 Për menaxhimin e sigurisë së informacionit, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit – *Mirembajtje Sisteme Sigurie*;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qenë se sistemi pjesë e prokurimit është e rëndësishme për sigurinë dhe vijueshmërinë e punës të sistemeve kritike në APD duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është e rëndësishme për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem

menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

- Përmbushja e standartit ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen dhe që lidhen me mirembajtjen e sistemeve. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Përmbushja e standartit ISO 27001:2022 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar që shoqëritë zoterojnë njohuritë si dhe procedurat e menaxhimit të sigurisë së informacionit që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të sigurisë.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për zbatimin e kontratës, duhet të ketë personelin kryesor, si më poshtë:

- a. *1 (një) Administrator Projekti PMP* ose ekuivalent. Punonjësi duhet që të figurojë në listë pagesat e 3 muajve të fundit;

Argumentim: Personi kerkohet të mundësojë një administrim të burimeve njerezore si dhe të jetë i aftë të ndjekë dhe garantojë koordinimin me efikasitet të burimeve të Operatorit për të garantuar përputhjen e veprimtarisë me nevojat e Autoritetit Portual. Këto burime, duhet të jenë të afta të mbështesin prirësitë apo nevojat e Portit dhe të përshkatojnë me kërkesat apo zhvillimet që Autoriteti Portual (APD) do të ketë përgjatë zbatimit të kontratës së *Mirembajtjes së Sistemeve të Sigurisë*. Suksesi i zbatimit të shërbimit të mirembajtjes në një masë të madhe nga mënyra e përshkatores së burimeve të operatorit ndaj kërkesave gjithnjë e më rritje të APD.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 10 punonjës në listë pagese, nga të cilët të paktën 3 nga këta punonjës duhet të jenë të diplomuar si inxhinjer Elektronik ose Informatik ose Kompjuterik ose Telekomunikacioni ose Elektrik. Për këta punonjës duhet të paraqiten Diplomat dhe duhet që të figurojnë në listë pagesat e 3 muajve të fundit.

Argumentimi :

Duke qene se mirembajtja do te kryhet ne pajisje sigurie te sistemeve te ndryshme te cilat jane te shtrira ne territor dhe ne ambjente te sigurise se larte, kerkohet qe OE qe do te zbatoje kontraten te kete staf te mjaftueshem dhe te kualifikuar per realizimin ne kohe dhe me cilesi te larte te kontrates.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, sipas kategorive më poshtë:

a) Kategoria 1 (Kritik / i Lartë)

Kerkesa	Argumentimi
Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi per Sistemet e Akses Bosch Security Systems Kontrollit ose ekuivalent. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Eshte kerkuar ky kriter pasi ne pajisjet e kerkuara eshte pjese edhe sistemi i Akses kontrollit, ky sistem eshte shume i rendesishem per sigurine e hyrjes ne server vetem te personave te autorizuar , per kete duhet qe te garantohet mirembajtja e funksionimit te vazhdueshem te sistemit nga punonjes te specializuar dhe te pajisur me certifikate kualifikimi.
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1(nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per Sisteme Alarmi Bosch Security Systems seria G ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Eshte kerkuar ky kriter pasi ne pajisjet per te cilat do te kryhet mirembajtje eshte pjese edhe sistemi i Alarmit. Sistemi i alarmit eshte nje sistem i rendesise se vecante per te garantuar sigurine e ambientit nga hyrje te pa autorizuar , nga vandalizmi ose nderhyrje nga keqeberes. Duke qene nje sistem i rendesishem duhet qe te garantohet mirembajtja e funksionimit te vazhdueshem dhe te besueshem per kete sistem. Per kete kerkohet qe mirembajtja te behet nga punonjes te kualifikuar.
Operatori Ekonomik duhet te kete nje punonjes te certifikuar ne per serverat e infrastruktures ekzistuese nga prodhuesi ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Mirembajtja e paisjeve hardware servera ku hostoen sherbimet virtuale, eshte nje nder detyrat kryesore te Operatorit ekonomik. Ne keto paisje procesohet cdo informacion I infrastruktures virtuale (si makina virtuale, databaza, aplikacione te brendeshme etj). Instalimi I updateve dhe I patcheve te fundit eshte kritik per keto paisje si dhe zevendesimi i komponenteve hardware ne rast difektshmerie.

Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 punonjes te certifikuar nga prodhuesi Storage Bosch DIVAR IP ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Qëllimi i kësaj kërkesë është të sigurohet që Operatori Ekonomik disponon kapacitete teknike dhe burime njerëzore të kualifikuara për mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve të ruajtjes së të dhënave të ndjeshme, të tilla si sistemet e monitorimit (CCTV), në përputhje me kërkesat teknike të prodhuesit dhe ligjin Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”.
Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi per Ndertimin e Sistemeve te Integruar Bosch Security Systems ose ekuivalent. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Eshte kerkuar ky kriter sepse eshte i rendesishem per faktin qe sistemi ku do te kryhet mirembajtja ka pajisje te cilat jane pjese te nje sistemi te integruar duke e bere nje sistem kompleks dhe shume sensitiv dhe qe kerkon kualifikim te larte te konfirmuar nga prodhuesi per mirembajtjen dhe grantimin e funksionimit te integruat te sistemeve.
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1(nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per Sistemet e Menaxhimit te VMS ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Ky kriter eshte shume i rendesishem pasi sistemi menaxhohet dhe administrohet nga nje platforme shume e larte e cila kerkon njohje shume te mira dhe te konfirmuar nga prodhuesi per te garantuar nje menaxhim te mire te sistemit video . Per kete kerkohet qe mirembajtja te behet nga punonjes te kualifikuar.

b) Kategoria 2 (Kritik / i Mesëm)

Kerkesa	Argumentimi
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi per Sistemin e Radiokomunikimit ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Eshte kerkuar ky kriter pasi ne pajisjet per te cilat do te kryhet mirembajtje eshte pjese edhe sistemi i Radiokomunikimit. Sistemi i Radiokomunikimit eshte nje sistem i rendesishem per te garantuar siguri dhe komunikim ne kohe reale.Duke qene nje sistem i rendesishem duhet qe te garantohet mirembajtja e funksionimit te vazhdueshem dhe te besueshem per kete sistem. Per kete kerkohet qe mirembajtja te behet nga punonjes te kualifikuar.
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1(nje) punonjes te certifikuar CCNA ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese të	Ky kriter eshte shume i rendesishem pasi sistemi i sigurise ekzistuese, ka nje rrjet komunikimi network te zgjeruar dhe shume cilesor i cili kerkon kompetenca te larta

vlefshme. Punonjesi duhet te figurojne ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	teknike per konfigurimin administrimin dhe monitorimin e rrjetit network . Per kete kerkohet qe mirembajtja te behet nga punonjes te kualifikuar.
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi certifikuar per telekamera IP ose ekuivalent. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Sistemet moderne të survejimit me IP janë të avancuara dhe kërkojnë njohuri specifike mbi konfigurimin e rrjetit, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave të videos, integrimin me sisteme të tjera të sigurisë, si dhe menaxhimin në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë kibernetike. Certifikimi nga prodhuesi ose një ekuivalent i pranuar vërteton se punonjësi ka kaluar trajnimin dhe testimin e nevojshëm për të punuar në mënyrë profesionale dhe të sigurt me këto pajisje.

c)Kategoria 3 (Kritik / i Ulët)

Kerkesa	Argumentimi
Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes qe eshte i certifikuar per Sigurine Kibernetike .Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Pajisjet e kerkuara prodhojne, transmetojne dhe administrojne informacione te rendesishme dhe sensitive te cilat kerkojne nje sistem dhe administrim te sigurve te te gjitha te dhenave. Me kete kriter kerkohet te garantohet siguria e informacionit nga nderhyrje kibernetike te qellimshme apo aksidentale. Per kete kerkohet qe mirembajtja te behet nga punonjes te kualifikuar.
Operatori ekonomik duhet te kete 1(nje) punonjes pergjegjes te certifikuar per sigurine dhe shendetin ne pune. Duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Kjo kërkesë vendoset me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe teknike në lidhje me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve gjatë zbatimit të kontratës.
Operatori ekonomik duhet te kete 1 punonjes te pajisur me certifikaten per elektriciste . Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.	Kjo kërkesë vendoset për të siguruar që Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore të kualifikuara për kryerjen e punimeve elektrike në përputhje me standardet e sigurisë dhe ligjshmërisë. Punimet që përfshijnë instalime, mirëmbajtje apo ndërhyrje në sisteme elektrike, përfshirë pajisjet e sigurisë, sistemet e mbikëqyrjes dhe

	infrastrukturën ndihmëse, kërkojnë njohuri specifike dhe përgatitje profesionale.
Operatori ekonomik duhet të ketë 1 punonjes të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente të licensuara. Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.	Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar se Operatori Ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të aftë për të kryer punë teknike në përputhje me kërkesat e sigurisë teknike të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar. Pajisja me kartelë të sigurimit teknik , e lëshuar nga ISHTI ose institucione të tjera të licensuara, është një dëshmi që individët janë të aftë fizikisht dhe profesionalisht për të punuar në ambiente dhe me pajisje që mbartin rrezik teknik.
Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 punonjes që janë të certifikuar për sistemet e fikjes së Zjarrit nga prodhuesi ose ekuivalent. Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.	Kjo kërkesë është vendosur me qëllim të garantimit të përmbushjes së standardeve të sigurisë kundër zjarrit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën e mira teknike. Sistemet e fikjes së zjarrit përfshijnë instalime komplekse me komponentë elektrikë, elektronikë dhe hidraulikë, të cilët kërkojnë njohuri specifike për mirëmbajtje.
Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 punonjes që janë të certifikuar për UPS nga prodhuesi ose ekuivalent . Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme. Punonjesi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.	Kjo kërkesë vendoset për të siguruar që Operatori Ekonomik ka kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore të nevojshme për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike. UPS-të janë pajisje kritike për mbrojtjen e sistemeve IT, rrjeteve dhe pajisjeve të tjera të ndjeshme nga ndërprerjet e energjisë elektrike apo fluktuacionet e tensionit. Ato kërkojnë njohuri të specializuara për përmasimin korrekt, integrimin me pajisje të tjera, testimin, diagnostikimin dhe konfigurimin sipas kushteve të ambientit ku përdoren.

Argumentim:

Në bazë të kategorive të ndryshme të sistemeve që APD disponon me poshtë është bërë një ndarje sipas kritikalishtit dhe rëndësisë së këtyre sistemeve. Kategoria kritike kërkon angazhim maksimal në përgjigje dhe njohuri për operatorin ekonomik pasi afekton komponente jetike të institucionit pa të cilat afektohen shërbime duke penguar aktivitetin operacional. Përcaktimet e detajuara në lidhje me kritikalishtet janë sipas tabelës me poshtë:

Kohet e Pergjigjes dhe te Zgjidhjes

Kodet e kritikitetit perdoren per te percaktuar kohen e duhur te pergjigjes dhe te zgjidhjes. Kohet e pergjigjes dhe te zgjidhjes llogariten qe nga momenti i hapjes se incidentit nga Grupi e Kontaktit te Kompanise. Nqs problemi nuk zgjidhet ne kohen e percaktuar, duhet te aplikohen perpjekje te vazhdueshme derisa problemi te rezultojte i zgjidhur.

Kategoria 1 (Kritik/ I Larte)	Kategoria 2 (I Mesem)	Kategoria 3 (I Ulet)
Sistemet dhe pjese te tjera kritike te sistemit jane plotesisht jashte pune.	Mosfunksionim pjesor infrastrukture. Probleme me komponente kritike qe jane redundante dhe jane objektiv i keqfunksionimit te High Availability. Probleme ne performance.	Mosfunksionimi i infrastruktures prek nen 15 % te sherbimeve ne suportit
Numri i perdoruesve te ndikuar		
Mos funksionim total i sistemit.	Mos funksionimi ndikon nje numer te vogel te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon pjeserisht vetem perdoruesit e nje departamenti/njesie
Pezullimi i punes		
Mos funksionimi pengon te gjitha perdoruesit <u>te realizojne punen e tyre.</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne pjese te punes se tyre qe kane lidhje kryesisht me institucione te tjera</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre,</u>
Zgjidhje alternative e perkohshme		
<u>Nuk ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjeserisht nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<u>Ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
Koha e pergjigjes		
- o 5~15 min. per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 1 ore.	- o 30 min per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda 8 oreve	- o 1 ore per te kthyer pergjigje - o Ne vend brenda dites se neserme te punes

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit aty ku kërkohet, CV-në e personelit dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Operatori Ekonomik ofertuese duhet te jete i autorizuar per mirembajtje dhe suportin per sistemet Bosch Security Systems, per kete duhet te paraqesin Autorizimin nga prodhuesi / Distributori i autorizuar nga prodhuesi (ne rastin e distributorit te autorizuar duhet te paraqitet dokumenti qe verteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit) per suportin ne territorin e Shqiperise. Ky autorizim duhet te jete i leshuar per objektin e tenderit dhe per autoritetin kontraktor.

Argumentimi:

Kjo kërkesë ka si qëllim të garantojë që shërbimi i mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike për sistemet Bosch Security Systems të ofrohet në përputhje të plotë me standardet e prodhuesit dhe me garancinë e aksesit të drejtëpërdrejtë në informacionin teknik, pajisje zëvendësuese, përditësime softuerike, dhe ndihmë teknike zyrtare.

Sistemet e sigurisë Bosch janë teknologji të ndjeshme dhe të specializuara, që përfshijnë module të integruara për video-survejim, alarmim kundër zjarrit, kontroll aksesi, dhe integrame të tjera inteligjente. Mbështetja dhe mirëmbajtja e tyre kërkon trajnim specifik, mjete teknike zyrtare dhe qasje në portalet teknike të prodhuesit – të cilat ofrohen vetëm për partnerët e autorizuar.

Prandaj, kërkesa për autorizim nga vetë prodhuesi ose distributori i tij zyrtar, si dhe dokumentacioni që vërteton këtë lidhje, siguron:

- Cilësi të garantuar në mirëmbajtje dhe ndërhyrje teknike.
- Zbatim të plotë të protokolleve të prodhuesit për diagnostikim dhe riparim.
- Përditësime softuerike zyrtare.
- Mbrojtjen e investimit të autoritetit kontraktor dhe funksionimin afatgjatë të sistemit.

Gjithashtu, kërkesa që autorizimi të jetë i lëshuar për objektin konkret të tenderit dhe për autoritetin kontraktor përkatës, siguron që bashkëpunimi i autorizuar nuk është i përgjithshëm apo i transferueshëm, por i dedikuar për këtë projekt specifik, duke garantuar përgjegjësi dhe përfshirje të drejtëpërdrejtë të prodhuesit në mbështetjen e kontratës.

Arsyetimi për mos ndarjen e kontratës së mirëmbajtjes në lote.

Kontratën e mirëmbajtjes nuk e kemi ndarë në lote të veçanta sepse e konsiderojmë këtë shërbim si një paketë të integruar, ku çdo komponent lidhet ngushtë me të tjerët. Për të garantuar një funksionim të qëndrueshëm, efikas dhe pa ndërprerje të sistemit, është e rëndësishme që mirëmbajtja të trajtohet në mënyrë të centralizuar dhe të unifikuar.

Fragmentimi në lote do të sillte rrezik për mbivendosje përgjegjësish, mungesë koherence në zgjidhjen e problemeve dhe vonesa në reagim. Në vend të kësaj, ne ofrojmë një zgjidhje të plotë që përfshin të gjitha aspektet e mirëmbajtjes – që nga përditësimet teknike dhe siguria, deri te mbështetja teknike dhe kontrolli i performancës – për të siguruar cilësi të lartë dhe përgjegjësi të qartë. Për më tepër, një kontratë e pandarë lejon që të ruhet konsistenca në cilësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes. Ajo mundëson një komunikim të drejtëpërdrejtë dhe të qartë mes palëve, si dhe eviton çdo keqkuptim apo vonesë që mund të lindë në rast të koordinimit mes ofruesve të ndryshëm. Në këtë mënyrë, sigurojmë jo vetëm mirëmbajtje të vazhdueshme dhe proaktive, por edhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemit në bazë të analizave të performancës dhe nevojave reale të përdoruesve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.
Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.